



BiEPAG

*Mbajtja e premtimit
të Selanikut:*

SI TA BËJMË ZGJERIMIN TË FUNKSIONOJË PËR TË GJITHË 20 VITE MË VONË?

Qershor 2023

*Nga Milica Delevic dhe Jovana Marovic,
me kontribut nga Tena Pelec*

*Falënderojmë Florian Bieber, Marko Kmezic, Richard
Grieveson, Gjergji Vurmo, Damir Kapidzic dhe Srdjan
Majstorovic për komentet e tyre.*

Abstrakt

Asnjë vend i Ballkanit Perëndimor nuk është pranë anëtarësimit: katër janë aktualisht të angazhuar në negociata, një ka statusin e vendit kandidat (me kusht) dhe një tjetër kohët e fundit ka bërë kërkesën për anëtarësim. Nëse e krahasojmë me pritshmëritë e mëdha të vitit 2003, situata aktuale është tejte zhgënjyese.

“E ardhmja e Ballkanit Perëndimor është brenda Bashkimit Evropian” –kështu lexohej angazhimi i BE-së për të ardhmen evropiane të Ballkanit Perëndimor dy dekada më parë. Këto fjalë u përfshinë për herë të parë në Deklaratën e Selanikut në qershor 2003, por, edhe pse BE nuk është tërhequr kurrë nga ky premtim për rajonin, që prej asaj kohe vetëm Kroacia është bërë anëtare. Aktualisht, asnjë vend tjetër nuk është pranë anëtarësimit: një ka marrë statusin e vendit kandidat (me kusht, dhe një tjetër kohët e fundit ka bërë kërkesën për anëtarësim. Nëse e krahasojmë me pritshmëritë e mëdha të vitit 2003, situata aktuale është tejte zhgënjyese.

Gjithsesi, pushtimi në shkallë të gjerë i Ukrainës nga Rusia ka ndryshuar situatën gjeopolitike në Evropë dhe në të gjithë botën. Krejt papritur, pas shumë vitesh gjatë të cilave qëllimi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian referohej si “perspektiva evropiane” në mënyrë që të dukej më pak përcaktuese dhe më pak kërcënuese për qytetarët e vendeve anëtare të BE-së, numri i kandidatëve dhe kandidatëve të mundshëm për t’iu bashkuar Unionit u rrit nga shtatë në dhjetë. Procesi i zgjerimit jo vetëm që është ringjallur, por karakterizohet tashmë edhe nga një ndjesi qëllimi të ripërtërirë dhe ngutësie. Tani është me rëndësi të jashtëzakonshme të sigurohemi që procesi të jetë i suksesshëm për të gjitha vendet e përfshira – si për ato në Ballkanin Perëndimor ashtu edhe për kandidatët e rinj në Evropën Lindore.

01. Pritja e gjatë: Si arritëm deri këtu

Dështimi i shteteve të Ballkanit Perëndimor për të ecur me ritme më të shpejta drejt anëtarësimit në BE pas Samitit të Selanikut¹ mund të shpjegohet me sërë faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm që ndërthuren me njëri tjetrin. Nga njëra anë, rajoni u përball me sfida që burojnë nga e kaluara e tij e trazuar, mangësitë me demokracinë dhe proceset e pamjaftueshme të reformave si dhe nga problemet dypalëshe me vendet anëtare të BE-së. Nga ana tjetër, dy dekadat pas samitit, BE po përballlet me krizën e Eurozonës dhe migracionin, Brexit-in, pandeminë Covid-19, kërcënimet ndaj shtetit ligjor në disa nga shtetet anëtare të saj dhe luftërat në kufijtë e saj lindorë dhe jugorë. Këto kriza e zhvendosën fokusin e BE-së nga Ballkani Perëndimor duke reduktuar kështu kohën dhe burimet që i ishin angazhuar këtij rajoni.

Procesi i anëtarësimit e humbi kështu vrullin dhe shpresat për anëtarësim u shtynë gjithnjë e më shumë për të ardhmen.

Ndërkohë që BE po shpërqendrohej gjithnjë e më shumë nga shqetësimet e tjera, gjatë gjithë kësaj periudhe shtetet e Ballkanit Perëndimor mbetën kryesisht të qëndrueshme – me përjashtim të disa rasteve me trazira. Edhe pse problemet e viteve 1990 nuk u zgjidhën asnjëherë plotësisht, ato mbaheshin mjaftueshëm nën kontroll për të shmangur kërcënimin ndaj sigurisë dhe stabilitetit në Evropë. Kjo eliminoi ndjesinë e ngutësisë lidhur me integrimin e rajonit në BE. Në të njëjtën kohë, shumë në BE ishin të bindur se rajoni nuk ishte ende gati për anëtarësim për shkak të politikës jofunksionale të këtyre vendeve, hapave prapa në demokraci, dobësive me shtetin ligjor,² dhe paaftësisë (ose mungesës së vullnetit) për të luftuar me vendosmëri korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Procesi i anëtarësimit e humbi kështu vrullin dhe shpresat për anëtarësim u shtynë gjithnjë e më shumë për të ardhmen. Kjo e gozhdoi BE-në dhe rajonin në një rreth vicioz hipokrizie – e para duke pretenduar se është serioze për zgjerimin dhe i dyti duke pretenduar se është serioz me reformat. Procesi i zgjerimit, që dikur shihej si instrumenti më i rëndësishëm i politikës së jashtme të BE-së, faktikisht ngeci në vend.³

1 Deklarata e Samitit BE-Ballkani Perëndimor në Selanik, 21 qershor 2003, https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/PRES_03_163

2 Jovana Marović, Tena Prelec dhe Marko Kmezić, 'Forcimi i shtetit ligjor në Ballkanin Perëndimor: Thirrje për një revolucion kundër partikularizmit', BiEPAG, 2019, <https://biepag.eu/wp-content/uploads/2021/07/Strengthening-the-Rule-of-Law.pdf>

3 Tena Prelec dhe Milica Delević, 'Më drejtpërdrejtë, më shpejt, më me paanshmëri – Si

02. Zhvendosjet radikale: Si e ka ndryshuar procesin lufta e Rusisë kundër Ukrainës

Pushtimi në shkallë të gjerë i Ukrainës nga Rusia ka ndryshuar situatën gjeopolitike si në Evropë ashtu edhe në të gjithë botën. Lufta në kontinentin evropian dhe vendosmëria e ukrainasve për të përmbushur synimin e tyre evropian – një qëllim që ata e kanë ndjekur që nga Revolucioni i Dinjitetit (Maidan) në 2014 – e kanë transformuar rrënjësisht dinamikën e zgjerimit të BE-së. Ukraina dhe Moldavia u bënë kandidatë në qershor të vitit 2022 dhe Gjeorgjia u rekomandua për dhënien e statusit të vendit kandidat me kusht që të bëjë përpërim të mëtijshëm në reformat politike.

Krejt papritur, pas shumë vitesh gjatë të cilave qëllimi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian referohej si “perspektiva evropiane” në mënyrë që të dukej më pak përcaktuese dhe më pak kërcënuese për qytetarët e vendeve anëtare të BE-së, numri i kandidatëve dhe kandidatëve të mundshëm për t’iu bashkuar Unionit u rrit nga shtatë në dhjetë. Kjo jo vetëm që ka ringjallur procesin e zgjerimit, por i ka dhënë atij një ndjesi qëllimi të ripërtërirë dhe ngutësie

Aplikimi që në fillim i Ukrainës për anëtarësim në BE menjëherë pas pushtimit rus nxiti reagime të ndryshme, veçanërisht tek vendet anëtare të Evropës Perëndimore, shumë prej të cilëve ishin bërë skeptikë ndaj zgjerimit dhe ishin të kujdesshëm për krijimin e një precedenti të një anëtarësimi “të shpejtë”. Gjithsesi, Ukraina ishte në gjendje të mbështetej tek avokatë të fortë në vendet anëtare të Evropës Qendrore dhe te Komisioni Evropian. Argumenti që përfundimisht ka bashkuar shtetet anëtare është mirëkuptimi i përbashkët se Putinit nuk duhet t’i jepet fitorja në këtë çështje.

të ringjallet vullneti politik i nevojshëm për ta bërë të suksesshëm zgjerimin për BP dhe BE-në, BiEPAG, 2020, <https://biepag.eu/flatter-faster-fairer-how-to-revive-the-political-will-necessary-to-make-enlargement-a-success-for-the-wb-and-the-eu/?fbclid=IwAR1PzFwDV0G0FOQDNAlcEU8WtCr2DwdMyBlx5qAbYrkoXis2R96AJcVACQO>

Pas vendimit historik të Këshillit Evropian për t'i dhënë Ukrainës dhe Moldavisë statusin e vendit kandidat, të dy vendet iu përgjigjën shpejt kërkesave për informacion, duke i bërë të mundur Komisionit të hartojë raporte ku jepen hollësi për prioritetet për të cilat do të duhet të punojnë të dy shtetet. Ukraina po bën thirrje tashmë për hapje të shpejtë të negociatave të anëtarësimit. Ajo e kupton se kostoja e tmerrshme e luftës në jetë njerëzish dhe në ekonominë e vendit përbën një rast të fortë moral dhe politik për ta çuar procesin përpara me shpejtësi dhe për të shmangur luftën e pafund teknike dhe burokratike që përjetuan kandidatët e tjerë. Bazuar në raportin e radhës nga Komisioni, Këshilli Evropian do të vendosë për këtë çështje deri në fund të vitit 2023.

Kësisoj, agresioni rus kundër Ukrainës i ka dhënë një rëndësi të re zgjerimit të BE-së, si shprehja më e fortë e mbështetjes dhe e angazhimit afatgjatë për të ardhmen e Ukrainës. Po ashtu, ai ka potencialin për të transformuar natyrën e procesit nëpërmjet të cilit anëtarët e ardhshëm do të hipin në bord. Për të qenë në gjendje për të akomoduar refugjatët që ikin nga lufta, BE nxit, për herë të parë, Direktivën e Mbrojtjes së Përkohshme, një instrument i hartuar në vazhden e lëvizjeve të refugjatëve të luftërave ballkanike. Kështu, qytetarët ukrainas mund të jetojnë dhe punojnë në BE dhe të marrin shërbimet sociale – të drejta që zakonisht jepen në fund të procesit të anëtarësimit.

Së fundi, shtetet anëtare të BE-së po sigurojnë municione dhe raketa dhe po i bashkëfinancojnë ato nëpërmjet Instrumentit Evropian për Paqen për të mbështetur përpjekjet e Ukrainës në luftë.

Për të ofruar mbështetje për sistemin energjetik të vendit, BE e integroi Ukrainën në sistemin energjetik të Evropës përmes sinkronizimit emergjent me Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (ENTSO E). Për të siguruar mbijetesën ekonomike të vendit, BE pezulloi të gjitha tarifatat dhe kuotat për importet e mallrave ukrainase. Mbështetja makrofinanciare prej 18 miliardë eurosh që i ka siguruar Ukrainës stabilitet dhe parashikueshmëri, u arrit nëpërmjet huamarrjes kolektive, e cila ishte zbatuar më parë vetëm në këtë shkallë në kontekstin e fondit të rimëkëmbjes së pandemisë së BE-së (NextGenEU). Së fundi, shtetet anëtare të BE-së po sigurojnë municione dhe raketa dhe po i bashkëfinancojnë ato nëpërmjet Instrumentit Evropian për Paqen për të mbështetur përpjekjet e Ukrainës në luftë.

Paralelisht me procesin formal të mirëpërcaktuar të zgjerimit (aplikimi, pyetësi, rekomandimet, hapja e negociatave të anëtarësimit, verifikimi), Ukraina ka përjetuar një integrim të pjesshëm de facto të shpejtë në BE. Kjo ka rezultuar jo nga një vendim i qëllimshëm për të ndryshuar procesin e zgjerimit, por si pasojë e integritetit që është mënyra më praktike për shtetet anëtare për t'i dhënë Ukrainës mbështetje të qëndrueshme. Ndonëse procesi formal mbetet i ngadalshëm dhe jo i zhdërvjellët, BE është treguar jashtëzakonisht e shpejtë dhe e zhdërvjellët në përmbushjen e nevojave emergjente të Ukrainës.

03. Implikimet për Ballkanin Perëndimor: shmangia e shkëputjes nga dy projekte zgjerimi

Peizazhi gjeopolitik në zhvillim dhe qasja e BE-së ndaj Ukrainës ka të ngjarë të kenë implikime të mëdha për Ballkanin Perëndimor. Pa dyshim më e rëndësishmja është ringjallja e procesit të zgjerimit, i cili mban çelësin e reformave të brendshme në rajon dhe zgjidhjen e problemeve të vjetra dypalëshe dhe rajonale. Edhe pse qeveritë e Ballkanit Perëndimor në përgjithësi shprehin mbështetje për Ukrainën, ato ngrenë shqetësime për krizën aktuale duke i larguar kështu përpjekjet dhe vëmendjen nga integrimi i tyre në BE, i cili mbetet i paplotë. Gjithsesi, BE, e vetëdijshme për pasojat negative të viteve të ngërçit dhe e motivuar nga rëndësia e ripërtërirë gjeopolitike e Ballkanit Perëndimor, e ka rritur së fundmi angazhimin e saj në rajon.

Presidenca franceze e BE-së bëri të mundur një kompromis për kundërshtimet e Bullgarisë ndaj negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut, ndonëse mbetet e pasigurt nëse Parlamenti në Shkup do të miratojë amendamentin e kërkuar në Kushtetutën e tij. Bosnje-Hercegovinës më në fund iu dha statusi i vendit kandidat gjashtë muaj pas Ukrainës dhe Moldavisë, por vendin vazhdojnë ta mbajnë peng çështjet e brendshme dhe politika toksike. Ndërkohë, Kosova do të përfitojë nga udhëtimi pa viza që nga janari i vitit 2024, edhe pse shumë vite pasi i kishte përmbushur fillimisht kushtet e kërkuara. Gjithsesi, aplikimi i saj

për anëtarësim, i dorëzuar në fund të vitit 2022, përballet me një të ardhme të pasigurt, duke qenë se në BE janë pesë vende anëtarë që nuk e njohin Kosovën si shtet të pavarur. Po ashtu, Gjermania dhe Franca (me mbështetjen e SHBA-së) kanë arritur të ringjallin dialogun Beograd-Prishtinë, ndonëse, pavarësisht marrëveshjes së arritur në mars në rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës, tensionet mbeten të larta, siç tregojnë edhe trazirat e fundit në zonat në veri të Kosovës, teksa perspektiva për zbatimin e marrëveshjes mbetet e pasigurt.

BE dhe anëtarët e saj kanë dhënë fonde të konsiderueshme shtesë për të mbështetur sigurinë energjetike të rajonit gjatë krizës, u zotuan të ecin përpara me diversifikimin e energjisë dhe tranzicionin e energjisë në afat të shkurtër dhe afatmesëm dhe ftuan Ballkanin Perëndimor të marrë pjesë në platformën e saj të përbashkët të blerjes për hidrokarburet. Progres është bërë edhe me përpjekjet për krijimin e një Tregu të Përbashkët Rajonal me nënshkrimin e marrëveshjeve për lëvizjen e lirë dhe njohjen reciproke të diplomave.⁴

Shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë përfituar më tej nga vendimi i Presidentit francez Emmanuel Macron për të krijuar një Komunitet Politik Evropian,⁵ që është një forum politik i nivelit të lartë për diskutime mes BE-së dhe partnerëve të saj lindorë dhe juglindorë në kuadër të agresionit rus. Më në fund, Brukseli po përmirëson kapacitetin e tij institucional: pas një ndërprerjeje të gjatë, Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR) ka një Drejtor të Përgjithshëm të ri dhe shumë pozicione të tjera vakante po plotësohen gradualisht. Shpresohet se nuk do të kalojë shumë kohë para se të emërohet një drejtor i ri për Ballkanin Perëndimor, gati tre vjet pas largimit të drejtorit të mëparshëm.

Gjithsesi, një nga problemet më kryesore që lidhen me angazhimin e BE-së me rajonin vazhdon të mbetet i pazgjidhur. Pavarësisht ndryshimit në metodologjinë e zgjerimit në vitin 2020⁶ për të bërë të mundur që progresi të shpërblehet me përfitime më të prekshme dhe për rikthim mbrapsht të procesit në rastin e hapave prapa, qasja e BE-së ka mbetur e dobët dhe e paqëndrueshme. Vendet që zbatojnë me sukses reformat ose ndërmarrin hapa të rëndësishëm ende nuk

4 Konkluzionet e Kryesisë së Samitit të Berlinit, 2022, https://www.berlinprocess.de/uploads/documents/chairs-conclusions-bp-2022_1678468722.pdf

5 Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të Francës, 'Komuniteti Politik Evropian', <https://www.diplomatie.gouv.fr/en/french-foreign-policy/europe/european-political-community/>;

Parlamenti Evropian, 'Përtej zgjerimit: Komuniteti Politik Evropian dhe reforma e politikës së zgjerimit', 2022, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2022/739209/EPRS_ATA\(2022\)739209_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2022/739209/EPRS_ATA(2022)739209_EN.pdf)

6 Komisioni Evropian, 'Përmirësimi i procesit të anëtarësimit – Një perspektivë e besueshme e BE-së për Ballkanin Perëndimor', 2020, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-02/enlargement-methodology_en.pdf

shpërblehen në mënyrë të prekshme. Po ashtu, BE nuk ka qenë e aftë të tregojë se ka kosto oportune që lidhen me ngecjen në vend ose hapat prapa.

(Mos)bashkimi me sanksionet e BE-së kundër Rusisë është një shembull i mirë. Edhe pse në metodologjinë e vitit 2020 theksohej nevoja për përafrim me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së, kjo e fundit ende nuk ka bërë dallimin mes vendeve që vendosën sanksione ndaj Rusisë dhe atyre që nuk e bënë një gjë të tillë. Duke dështuar më parë në përdorimin e metodologjisë së re për të integruar vendet e rajonit në politikat kyçe sektoriale, BE tani po minon edhe më shumë besueshmërinë e qasjes së saj të re.

Edhe nëse duket se, për herë të parë pas një kohe të gjatë, ka një mundësi të vërtetë për të ecur përpara, mbeten dy probleme. E para është vazhdimësia e problemeve të brendshme, të tilla si strukturat jofunksionale dhe hapat prapa në drejtim të demokracisë si dhe një sërë çështjesh dypalëshe të pazgjidhura. E dyta është mungesa e besimit. Elitat dhe qytetarët e Ballkanit Perëndimor, pasi kanë dëgjuar kaq shumë për “perspektivën evropiane” të rajonit, kanë pak besim në garancitë e BE-së dhe ndjejnë njëfarë zhgënjimi për nisjen nga BE të një tjetër projekti zgjerimi pa përmbushur premtimin që i ka bërë Ballkanit Perëndimor njëzet vjet më parë.

04. Ta bësh zgjerimin të funksionojë në rrethana të reja

Paaftësia e BE-së për të integruar me sukses Ballkanin Perëndimor pas luftërave të viteve 1990 dhe ambivalenca e saj ndaj perspektivave të anëtarësimit të Gjeorgjisë, Moldavisë dhe Ukrainës ndoshta luajtën një rol të rëndësishëm në nxitjen e agresionit të Rusisë. Nga ana tjetër, pushtimi i Ukrainës ka evidentuar rëndësinë e procesit të zgjerimit si instrumenti gjeopolitik më efikas i BE-së, ndërkohë që edhe demonstroi se si mund të funksionojë më mirë ky proces. Tani është me rëndësi të jashtëzakonshme të sigurohemi që procesi të jetë i suksesshëm për të gjitha vendet e përfshira – si për ato në Ballkanin Perëndimor ashtu edhe për kandidatët e rinj në Evropën Lindore. Që të ndodhë kjo, duhet të merren parasysh vëzhgimet e mëposhtme:

o1. Të pranohet situata e re dhe të shfrytëzohet nga momenti. Për herë të parë pas një kohe të gjatë, duket se ka një mirëkuptim mes udhëheqësve evropianë se për zgjerimin duhet të ecet më tej me vendosmëri. Politikanët e Ballkanit Perëndimor duhet të kuptojnë se për të përfituar nga ky moment, vendet e rajonit duhet t'i zbatojnë tani reformat. Është po aq urgjentisht e nevojshme si në BE ashtu edhe në Ballkanin Perëndimor të rritet mbështetja e njerëzve për zgjerimin. Në shtetet anëtare duhet të shpjegohet qartë rasti gjeopolitik për anëtarësimet e ardhshme. Në rajon, elitat politike dhe aktorët e shoqërisë civile do të duhet të mobilizohen për të kapërcyer cinizmin e përhapur dhe për të rikthyer besimin në rrugën drejt një të ardhmeje brenda BE-së.

Në të gjitha zgjerimet e mëparshme ka pasur një çast kur përcaktohej data e synuar për përmbylljen e procesit. Kjo ndihmon që vendet të mbledhin mendjen dhe të shfrytëzojnë plotësisht momentin për arritjen e rezultateve të nevojshme.

o2. Zgjerimi tani është një proces që shkon përtej Ballkanit dhe duhet përshtatur me qëllim që të funksionojë për të gjithë në rrethanat e reja. Do të jetë e rëndësishme të përmirësohen lidhjet mes vendeve në procesin e zgjerimit për të siguruar që të gjithë pjesëmarrësit të ndjejnë se kanë potencial për të ecur përpara. Me faktin se Ukraina shihet si një prioritet dhe me Ballkanin Perëndimor që inkurajohet për të nxitur lidhje më të ngushta të brendshme, ekziston rreziku i ndarjes së zgjerimit në dy procese të veçanta. Moldavia, e cila fillimisht ishte përfshirë në Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe aktualisht është e prekur rëndë nga lufta në Ukrainë, mund të luajë një rol kyç si një urë lidhëse midis dy rajoneve.

o3. Vullneti politik për të çuar përpara zgjerimin dhe për t'i bërë rezultatet e tij më të prekshme është më i rëndësishëm se rihartimi i procesit teknik. Integrimi i pjesshëm i Ukrainës gjatë vitit të kaluar u zhvillua pa asnjë ndryshim në metodologjinë e zgjerimit. Si rezultat, Ukraina është sot në disa aspekte më e integruar në BE sesa vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky kombinim i angazhimit politik dhe integritit de facto në fusha të ndryshme sektoriale duhet të zbatohet tani për të gjitha vendet. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka premtuar së fundmi se do ta sjellë Ballkanin Perëndimor më afër Tregut të Vetëm të BE-së si pjesë e planit të ri të rritjes për rajonin. Mbetet për t'u parë nëse ky do të jetë një gjest tjetër simbolik dhe nëse do të konkretizohet me hapa të

mëdha në vijim. Integrimi duhet të vazhdojë sa më shpejt në sa më shumë fusha që të jetë e mundur dhe me fleksibilitetin më të madh. Kjo do të ishte në interes edhe të Ukrainës, pasi çështjet buxhetore, institucionale dhe të qeverisjes do të ngadalësojnë në mënyrë të pashmangshme edhe procesin e anëtarësimit të saj. Kufizimet e importit të vendosura së fundmi nga qeveritë e Evropës Qendrore për grurin ukrainas për të mbrojtur fermerët e tyre janë një shembull i kahershëm.

o4. Uniteti politik për çështje të rëndësishme është një kërkesë kyçe për progres. Koherenca dhe vendosmëria e demonstruar nga BE për t'iu përgjigjur agresionit të Rusisë, duke arritur një nivel të ngjashëm për unitetin për çështjet që mundojnë zgjerimin e Ballkanit Perëndimor, do të ishin po aq të rëndësishme. Dallimi në qasjen e BE-së për Malin e Zi dhe Kosovën, dy shtetet më të reja në rajon, është një rast i tillë. BE ishte e bashkuar për çështjen e krijimit të shtetit të Malit të Zi. Ajo luajti një rol të rëndësishëm ndërmjetësues në përgatitjen e kushteve për referendumin për pavarësinë e vendit, gjë që ia bëri më të lehtë Malit të Zi hapjen e negociatave të anëtarësimit në vitin 2012. Si për kontrast, BE është ende e ndarë për sa i përket njohjes së pavarësisë së Kosovës, gjë që bëhet pengesë e madhe për Kosovën në rrugëtimin e saj drejt anëtarësimit. Fokusi i ri gjeopolitik i Evropës duhet të bëjë të mundur përfundimisht tejkalimin e kësaj ndarjeje.

o5. Konsistenca në shpërblimin e progresit - dhe demonstrimi se kthimi prapa ka një kosto - është me rëndësi shumë të madhe. Shembulli më i gjallë i kësaj është Maqedonia e Veriut. Një ish-kandidat në procesin e zgjerimit - pasi kishte marrë statusin e vendit kandidat në 2005 - ky vend ka humbur pothuajse dy dekada duke u përpjekur të zgjidhë mosmarrëveshjen e tij dypalëshe me Greqinë. Pas ndryshimit të emrit dhe përmbushjes së kërkesave të BE-së, hapjes së bisedimeve të anëtarësimit iu vu vetoja fillimisht nga Franca dhe më pas nga Bullgaria. Kjo ka destabilizuar situatën politike në vend dhe ka çuar në një rënie të ndjeshme të mbështetjes për BE-në.

o6. Progresi drejt zgjerimit kërkon financim të qëndrueshëm, të parashikueshëm dhe të vazhdueshëm. Kjo duhet të reflektohet në planifikimin financiar të BE-së dhe të mbështetet duke sjellë institucione financiare ndërkombëtare dhe kapital privat. BE ka ofruar mbështetje të konsiderueshme financiare për Ballkanin

Perëndimor dhe është përpjekur të mbledhë aktorë të tjerë për të shfrytëzuar sa më shumë fondet e saj, përfshirë këtu miratimin e Planit Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor që u miratua në vitin 2020. Gjithsesi, financimi nuk ka marrë përherë parasysh nevojat e vërteta të rajonit dhe pritshmëritë e krijuara nga premtimet e BE-së. Presidentja e Komisionit Von der Leyen njoftoi kohët e fundit për një rritje të mëtejshme të financimit të para-aderimit si pjesë e planit të ri të Komisionit për Ballkanin Perëndimor për rritjen e rajonit, por mbetet për t'u parë se sa e madhe do të jetë kjo rritje. Qasje e mirë për financimin e një modeli të përshtatshëm për sigurimin e fondeve do të ishte një kornizë e hapur financiare, e ngjashme me Kornizën e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF), ku institucionet financiare ndërkombëtare, donatorët dypalësh dhe përfituesit punojnë së bashku me Komisionin. Si viktimë e një lufte agresioni, Ukraina kërkon një qasje specifike (dhe së shpejti do të krijohet një strukturë e re për Ukrainën), por Moldavia mund të futet potencialisht në WBIF nëse sigurohen fonde shtesë për kornizën.

o7.

Me rëndësi janë qartësia dhe fokusi. Përhapja e nismave, shumica e të cilave kanë të bëjnë me integrimin rajonal, rrezikon të eklipsojë si progresin ashtu edhe pengesat. Nisma të tilla shpesh duken si zëvendësues të progresit real drejt zgjerimit. Prandaj, Ukraina dhe mbështetësit e saj në BE kishin të drejtë që ngulën këmbë që Komuniteti Politik Evropian i sapokrijuar nuk duhet të konsiderohet në asnjë mënyrë si zëvendësim për anëtarësimin në BE. Nismat që shpesh janë të mbivendosura me nivele të ndryshme pjesëmarrjeje e bëjnë të vështirë të kuptohet se çfarë janë në të vërtetë gjithëpërfshirja dhe suksesi në bashkëpunimin rajonal. Një shembull i dukshëm është nisma e Ballkanit të Hapur, e nisur nga tre vende të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia), e cila mbivendoset me Tregun e Përbashkët Rajonal, një nismë e ngjashme, por më gjithëpërfshirëse e mbështetur në kontekstin e procesit të Berlinit.

o8.

Me rëndësi janë edhe kapacitetet, si në BE ashtu edhe në vendet candidate. Dorëzimi i dosjes së zgjerimit të një anëtar i Komisionit Evropian nga një parti politike që perceptohet gjerësisht si argument kundër zgjerimit ishte një gabim i madh që nuk duhet të përsëritet. Do të jetë po aq e rëndësishme që të mos lejohet që Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë, e cila merret me vendet rreth BE-së dhe për këtë arsye është me

rëndësi të jetë e sigurt dhe e qëndrueshme, të ketë personel të pamjaftueshëm në të gjitha nivelet për periudha të gjata kohore. Nga ana e vendeve candidate, administratat e Ballkanit Perëndimor dhe aktorët e shoqërisë civile kanë përvojë të konsiderueshme në ndërveprim me njëri-tjetrin dhe me BE-në. Mësimet e nxjerra se si të organizohen, si të komunikohen dhe çfarë të shmangen duhet të ndahen vazhdimisht me Gjeorgjinë, Moldavinë dhe Ukrainën.

09.

Vëmendja e nivelit të lartë politik mbetet thelbësore. Nëse nuk do të ishte pushtimi i Ukrainës nga Rusia, zgjerimi do të ishte ende në duart e teknokratëve si në Bruksel ashtu edhe në vendet candidate. Varësia e tepërt të teknokratët është një tregues i qartë se politikanët besojnë se procesi i zgjerimit nuk ka gjasa të përparojë. Në këtë mënyrë është e sigurt se humbet mbështetja e publikut si në vendet që aspirojnë anëtarësimin ashtu edhe në vendet anëtare të BE-së, jo më pak për shkak të natyrës së padepërtueshme të zhargonit burokratik të BE-së. Kjo e fundit duhet të shmangë, nga ana tjetër, krijimin e përshtypjes se përmbushja e kriterëve teknike mund të kompensojë mungesën e progresit në reformat e vërteta thelbësore.

10.

Kriteret bazë janë me të vërtetë të një rëndësie themelore. Dhjetë vjet më parë, Komisioni prezantoi qasjen “në fillim kriteret bazë” për zgjerimin, gjë që do të thotë se pa rezultate konkrete për demokracinë dhe shtetin ligjor nuk do të ketë përparim të përgjithshëm drejt negociatave. Që nga ajo kohë, Serbia dhe Mali i Zi, dy vendet pararojë në negociatat e anëtarësimit, kanë rënë në renditjen e Freedom House nga “i lirë” në “pjesërisht i lirë”. Integrimi i Ukrainës ndihmohet nga dëshira e udhëheqësve të BE-së për të pasur Volodymyr Zelenskyn në tryezë, ku presidenti ukrainas konsiderohet si një udhëheqës demokratik që përballet me imperializmin rus. Por nëse përpiqen të imitojnë Viktor Orbanin e Hungarisë, udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor nuk do të kenë gjasa të marrin një përgjigje kaq të mirëpritur. Liderët e BE-së, nga ana e tyre, duhet të komunikojnë rëndësinë jetike të kriterëve politike të procesit të zgjerimit dhe të shpjegojnë qartë se demokracia është një vlerë kyçe evropiane, pa të cilën përparimi drejt BE-së do të jetë i pamundur.



Rreth nesh

Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (Balkans in Europe Policy Advisory Group -BiEPAG) është një nismë e përbashkët e Fondit Evropian për Ballkanin (European Fund for the Balkans - EFB) dhe Qendrës për Studimet e Evropës Juglindore të Universitetit Graz (CSEES) që promovon integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor dhe konsolidimin e vendeve demokratike e të hapura në rajon. BiEPAG bazohet te vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Ai respekton vlerat që janë të përbashkëta për një shoqëri ku mbizotërojnë pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia mes grave dhe burrave. Ky grup përbëhet nga studiues të njohur politikash nga rajoni dhe vende të tjera të Evropës që kanë njohuri të thella për Ballkanin Perëndimor dhe për proceset që formësojnë këtë rajon. Anëtarët e këtij grupi janë: Florian Bieber (Koordinator), Bojan Baća, Matteo Bonomi, Dimitar Bechev, Srđan Cvijić, Marika Djolai, Milica Delević, Nikola Dimitrov, Vedran Džihic, Richard Grieveson, Donika Emiri, Dejan Jović, Marko Kmezić (Asistent koordinator), Srđan Majstorović, Jovana Marović, Zoran Nechev, Damir Kapidžić, Tena Prelec, Corina Stratulat, Nikolaos Tzifakis, Alida Vračić, Gjergji Vurmo, Natasha Wunsch.

<https://biepag.eu>

Kontakt: MILENA STEFANOVIĆ, Drejtore Programi

milena.stefanovic@balkanfund.org

Fondi Evropian për Ballkanin është një nismë e përbashkët e Fondacionit Erste, Fondacionit Robert Bosch dhe Fondacionit King Baudouin që parashikon dhe lehtëson nisma që forcojnë demokracinë, nxisin integrimin evropian dhe afirmojnë rolin e Ballkanit Perëndimor në trajtimin e sfidave të Evropës. Strategjia e saj është e përqendruar në tre fusha gjithëpërfshirëse - promovimi i demokratizimit, përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe nxitja e integritetit në BE.

Fondacioni mbështet procesin e afirmimit të efikasitetit të politikës së zgjerimit të BE-së në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke përmirësuar bashkëpunimin rajonal mes organizatave të shoqërisë civile bazuar në solidaritet dhe dialog sipas kërkesës. Ai ofron mjetet dhe platforma ku qytetarë të informuar dhe të fuqizuar të ndërmarrin veprime në kërkim të institucioneve të përgjegjshme dhe demokracisë. Fokusi është te reformat e vazhdueshme të politikave dhe praktikave të vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE.

www.balkanfund.org

Kontakt: ALEKSANDRA TOMANIĆ, Drejtore Ekzekutive

aleksandra.tomanic@balkanfund.org

Qendra për Studime të Evropës Juglindore u krijua në nëntor 2008 pas vendosjes së Evropës Juglindore si përparësi strategjike në Universitetin e Grazit në vitin 2000. Qendra është një institucion ndërdisiplinar me pjesëmarrje të disa fakulteteve për kërkimin dhe arsimin, që ka si qëllim të sigurojë hapësirë për aktivitetet e pasura mësimore dhe kërkimore në universitet për Evropën Juglindore dhe të promovojë bashkëpunimin ndërdisiplinor. Po ashtu, Qendra synon të ofrojë informacione dhe dokumentim dhe të jetë pikë kontakti për mediat dhe publikun e interesuar në Evropën Juglindore përsa i përket zhvillimeve politike, ligjore, ekonomike dhe kulturore. Në kërkimet për Evropën Juglindore ka kontribuar një ekip ndërdisiplinor juristësh, historianësh dhe shkencëtarësh politikë, përmes artikujve, monografive dhe botimeve të tjera. Qendra organizon rregullisht konferenca dhe seminare ndërkombëtare për të promovuar hulumtime të mirëfillta shkencore për Evropën Juglindore

<http://csees.uni-graz.at/>

Kontakt: Profesor Universiteti DR. FLORIAN BIEBER,

Profesor i Studimeve të Evropës Juglindore

florian.bieber@uni-graz.at

©Fondi Evropian për Ballkanin 2020. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë vetëm ato të autorit(ve) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo pikëpamjet e Fondit Evropian për Ballkanin.



